

VENDIM
Nr. 269, datë 29.3.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË
KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE,
NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË
STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E
SHKOLLIMIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 698, datë 21.11.2018; nr. 779, datë 26.12.2018; nr. 40, datë 23.1.2019; nr. 251, datë 27.3.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të neneve 1 dhe 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të neneve 2 dhe 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të neneve 1 dhe 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, dhe të neneve 5 dhe 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore””, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshihen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët, të cilët janë pranuar në programe të studimeve profesionale, programe të ciklit të parë të studimeve ose programe të integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, të kategorive, si më poshtë vijon:

a) Studentët e pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që përllogaritet si mesatare e thjeshtë e këtyre treguesve:

i) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;

ii) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

b) Studentët e regjistruar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitet pas të parit, me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) të vitit paraardhës akademik, të përllogaritur me kreditet dhe notat e atij vitit akademik, nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar.

c) Studentët, të cilët u përkasin shtresave sociale në nevojë, si më poshtë vijon:

i) studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike;

ii) bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë;

iii) studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;

iv) studentët, të cilët kanë, të paktën, njërin prind person me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;

v) studentët, të cilët i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;

vi) studentët, të cilët janë të tretët e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë;

vii) studentët, të cilët kanë përfutur statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

viii) studentët, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjyqate të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç;

ix) studentët, të cilët janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfutur statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;

x) studentët, të cilët janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;

xi) studentët romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit;

xii) studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.

2. Studentët aplikojnë për përjashtim nga tarifrat, sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim, me dokumentacionin provues të plotësimin të kritereve në momentin e regjistrimit pranë institucioneve publike të arsimit të lartë ose në momentin që plotësojnë kriteret, sipas këtij vendimi.

2.1. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës, kryejnë verifikimet e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit, në bashkëpunim me institucionet që kanë detyrimin ligjor për të konfirmuar dokumentacionin dhe i dërgojnë për shqyrtim e miratim në bordin e administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë.

2.2. Bordi i administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë shqyrton dhe merr vendim për përjashtim nga tarifrat për studentët, të cilët përmbushin kriteret sipas këtij vendimi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga studenti. Përjashtimi nga tarifrat bëhet nga data e regjistrimit, në rastet e aplikimit në fillim të vitit akademik, ose nga muaji pasardhës, kur studenti ka paraqitur kërkesën gjatë vitit akademik, në rast plotësimi të kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

2.3. Vendimet e bordit të administrimit për miratimin e përjashtimit nga tarifrat bëhen publike dhe ankimohen sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

2.4. Vendimi i bordit të administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë i njoftohet Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e marrjes së vendimit.

2.5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me LAL-të publike, sipas kritereve të parashikuara në këtë vendim, parashikon numrin e pritshëm të studentëve, të cilët përfutojnë përjashtim nga tarifrat në periudhën afatmesme dhe efektet financiare, si pjesë e programit buxhetor afatmesëm.

3. Individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.

4. Studentit përsëritës i ndërpritet mbështetja nga fondet publike, me përjashtim të rasteve të forcave madhore.

4.1 Përjashtimisht, për vitin akademik 2018-2019, të gjithë studentët e regjistruar në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve, të cilët plotësojnë kriteret e këtij vendimi dhe nuk kanë përfutur përjashtim nga tarifrat sipas këtij vendimi, me vendim të njësitë të vetëqeverisjes vendore apo me vendim të bordit të administrimit të LAL-së publike, plotësojnë formularin e kërkesës dhe dokumentacionin provues të plotësimin të kritereve përkatëse për të përfutur përjashtim nga tarifrat sipas

këtij vendimi, brenda 20 (njëzet) ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e kërkesës, LAL-të publike kryejnë verifikimet e nevojshme dhe i dërgojnë për shqyrtim e miratim në bordin e administrimit. Bordi i administrimit miraton përjashtimin nga tarifat për studentët, të cilët përmbushin kriteret sipas këtij vendimi, brenda 5 (pesë) ditëve. Përjashtimi nga tarifat miratohet nga muaji janar 2019 dhe në vijim.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi